



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU  
ENERGY REGULATORY OFFICE



# Raport përfundimtar për të hyrat e lejuara maksimale të FSHU-së

Përgjigje ndaj Komenteve

Përshtatja vjetore për FSHU për vitin 2023

## DEKLARATË

Ky Dokument është përgatitur me qëllim të informimit të palëve të interesit gjatë procesit të konsultimit publik. Dokumenti duhet të lexohet krahas Raportit Konsultativ të ZRRE-së të publikuar më 16 shkurt 2023. Dokumenti nuk paraqet Vendim të ZRRE-së dhe nuk duhet të konsiderohet si i tillë.

23 mars 2023

## **Përmbajtja**

<b>Tabela e shkurtesave</b>	<b>4</b>
<b>1. Hyrje</b>	<b>5</b>
<b>2. Komentet nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)</b>	<b>6</b>
2.1 Ndryshimi i çmimit të energjisë për mbulimin e humbjeve në transmetim	6
2.1.1 Komentet e KEK	6
2.1.2 Përgjigjja e ZRRE-së	6
<b>3. Komentet nga Sindikata e pavarur Elektrokosova KEDS/KESCO</b>	<b>7</b>
3.1 Ngritja e pagave për punonjësit e kompanisë KEDS/KESCO	7
3.1.1 Komentet e Sindikatës së pavarur Elektrokosova KEDS/KESCO	7
3.1.2 Përgjigjja e ZRRE-së	7
<b>4. Komentet nga Qeveria e Republikës së Kosovës</b>	<b>8</b>
4.1 Ndarja e subvencioneve	8
4.1.1 Komentet e Qeverisë së Republikës së Kosovës	8
4.1.2 Përgjigjja e ZRRE-së	8
4.2 Mbulimi i hendekut për HLM për 2023 të bëhet kryesisht nga bizneset	8
4.2.1 Komentet e Qeverisë së Republikës së Kosovës	8
4.2.2 Përgjigjja e ZRRE-së	8
4.3 Lakorja e çmimeve të importit	9
4.3.1 Komentet e Qeverisë së Republikës së Kosovës	9
4.3.2 Përgjigjja e ZRRE-së	9
4.4 Kostot për Fondin e BRE	9
4.4.1 Komentet e Qeverisë së Republikës së Kosovës	9
4.4.2 Përgjigjja e ZRRE-së	9
<b>5. Komentet nga Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës</b>	<b>10</b>
5.1 Shqyrtimi i subvencioneve dhe shmangja e rritjes së tarifave	10
5.1.1 Komentet e ZPRK-së	10
5.1.2 Përgjigjja e ZRRE-së	10
<b>6. Komentet nga FSHU - KESCO</b>	<b>11</b>
6.1 Kostot e blerjes së energjisë me shumicë për vitin 2023	11
6.1.1 Komentet e KESCO	11

6.1.2	Përgjigjja e ZRRE-së	11
6.2	Kostot e lejuara me pakicë	12
6.2.1	Komentet e KESCO	12
6.2.2	Përgjigjja e ZRRE-së	12
6.3	Përshtatjet dhe Faktori Korrigjues i të Hyrave	12
6.3.1	Komentet e KESCO	12
6.3.2	Përgjigjja e ZRRE-së	12
<b>7.</b>	<b>Përmbledhje e MAR të FSHU (KESCO)</b>	<b>13</b>

## Tabela e shkurtesave

Shkurtesat e përdorura në këtë dokument kanë këtë kuptim:

CPI	Consumer Price Index
EEX	European Energy Exchange
EUROSTAT	European Statistical Office
FSHU	Furnizuesi i Shërbimit Universal
HLM/MAR	Të Hyrat e Lejuara Maksimale
KEDS	Kompania Kosovare e Shpërndarjes dhe Furnizimit të Energjisë Elektrike
KEK	Korporate Energjetike e Kosovës
KESCO	Kompania Kosovare e Furnizimit me Energji Elektrike
KESH	Korporata Elektroenergjetike Shqiptare
KOSTT	Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut i Kosovës
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MWh	Megavat orë
OPEX	Operational Expenditure- Shpenzimet Operative
OSSH	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes
OST/OT	Operatori i Sistemit, Transmisionit , Operatori i Tregut
PRR 3	Periudha e Tretë Rregullative
ZPRK	Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovë
ZRRE	Zyra e Rregullatorit për Energji

## 1. Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është në procesin e Përshtatjes së Rregullt të të Hyrave të Lejuara Maksimale (HLM) për Furnizuesin me Shërbim Universal (FSHU). Gjatë këtij procesi do të përcaktohet HLM për FSHU që mund t'i mbulojë për furnizimin e konsumatorëve të rregulluar.

Ky dokument paraqet përgjigjet në komentet e dhëna nga palët e interesuara dhe propozimin përfundimtar të ZRRE-së lidhur me të Hyrat e Lejuara Maksimale të FSHU-së për vitin kalendarik 2023, sipas të cilit përcaktohet tarifatat që aplikohen për vit relevant tarifaror 1 prill-31 mars. Pas vlerësimit fillestar të aplikacioneve lidhur me të Hyrat e Lejuara Maksimale për të licencuarin e Furnizuesit me Shërbim Universal (FSHU/KESCO), i licencuari dhe palët tjera të interesit kanë pasur mundësi të paraqesin komentet e tyre përmes konsultimit publik për periudhë dy javore.

Lidhur me vlerësimin fillestar të të Hyrave të Lejuara Maksimale të FSHU-së, ZRRE ka pranuar komente nga:

- Korporata Energjetike e Kosovës (KEK),
- Sindikata e pavarur Elektrokosova KEDS/KESCO,
- Qeveria e Kosovës,
- Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës, dhe
- FSHU – KESCO

Komentet e pranuar nga palët e interesit janë publikuar në faqen elektronik të ZRRE-së. Në këtë pjesë të Dokumentit japim një përmbledhje të këtyre komenteve si dhe përgjigjet e ZRRE-së mbi to.

## 2. Komentet nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)

### 2.1 Ndryshimi i çmimit të energjisë për mbulimin e humbjeve në transmetim

#### 2.1.1 Komentet e KEK

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) thekson se marrëveshja aktuale për çmime me palët KEDS, KESCO dhe KOSTT skadon me datën 31.03.2023. Për shkak të ndryshimeve në kostot e eksploatimit të thëngjillit, prodhimit të energjisë elektrike nga Termocentralet si dhe nga rritja e tarifave të KOSTT, KEK kërkon nga palët që të marrin parasysh çmimet e rishikuara nga KEK për periudhën 01.04.2023 – 31.03.2024 siç vijojnë:

- Çmimi i energjisë elektrike për mbulimin e Furnizimit për Shërbim Universal – 32.40 €/MWh;
- Çmimi i energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në shpërndarje – 39.54 €/MWh;
- Çmimi i energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në transmetim – 39.54 €/MWh;

#### 2.1.2 Përgjigjja e ZRRE-së

Duhet të theksohet se me ndryshimet ligjore që rregullojnë sektorin e energjisë të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në vitin 2016, ZRRE ka amandamentuar legjislacion sekondar për të qenë në harmoni me legjislacionin primar, prandaj në këtë kuptim çmimet e prodhimit për gjeneratorin publik KEK nuk rregullohen nga ZRRE që nga viti 2017, por ato i nënshtrohen kushteve të tregut. Çmimi për të cilin palët tregtare mund të arrijnë pajtimin ndërmjet tyre duhet të jetë në pajtim me Procedurën për Tregtimin e Energjisë, Rregullat e Tregut dhe kërkesat tjera të legjislacionit sekondar.

ZRRE deri me tani nuk ka pranuar ndonjë kërkesë ndryshe nga palët të Hyrat e Lejuara Maksimale të të cilave i nënshtrohen rregullimit. Prandaj, në vlerësimin e kostove me shumicë për vitin 2023, ZRRE ka marrë në konsideratë propozimet e palëve që bazohen në çmimet aktuale. Sidoqoftë, palët duhet të respektojnë parimet e sipërpërmendura në azhurnimet e çmimeve me shumicë në të ardhmen.

### **3. Komentet nga Sindikata e pavarur Elektrokosova KEDS/KESCO**

#### **3.1 Ngritja e pagave për punonjësit e kompanisë KEDS/KESCO**

##### *3.1.1 Komentet e Sindikatës së pavarur Elektrokosova KEDS/KESCO*

Sindikata e pavarur Elektrokosova KEDS/KESCO kërkon nga ZRRE që të merr parasysh ngritjen e pagave për punonjësit e kompanisë KEDS/KESCO, në vlerën e OPEX për OSSH dhe FSHU. Sindikata e pavarur Elektrokosova KEDS/KESCO i bazon këto kërkesa në:

- Rritjen e çmimeve të produkteve bazë
- Rritjen e inflacionit
- Rritjen e volumit të punës
- IkJen e numrit të madh të punëtorëve profesional

##### *3.1.2 Përgjigjja e ZRRE-së*

Sipas metodologjisë tarifore, ZRRE ka rishikuar kostot e OPEX (ku përfshihen edhe kostot e personelit) duke reflektuar normën vjetore të inflacionit. Norma e inflacionit merr parasysh Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit të publikuar nga Eurostat. Vlera e publikuar në janar të vitit 2023 për vitin 2022 është 8.4%.<sup>1</sup>

Vlen të theksohet se me qëllim që kostot e personelit të KEDS dhe KESCO të jenë të krahasueshme me kostot e personelit të të licencuarve të tjerë në sektorin e energjisë, ZRRE në kuadër të shqyrtimit periodik për periudhën rregullative 2018- 2022 ka azhurnuar kostot e personelit për KESCO në vlerë prej 251 mijë euro, dhe për KEDS dhe KESCO në total në vlerë prej rreth 2.3 milion euro. Këto kosto janë pjesë përbërëse e OPEX-it të FSHU-së.

Tutje duhet sqaruar për Sindikatën, se ZRRE në pajtim me kornizën ligjore ka azhurnuar dhe do të azhurnojë kostot e OPEX (përfshirë kostot e personelit) për të pasqyruar inflacionin. Prandaj, çështjet e ngritura nga sindikata duhet adresuar në KEDS dhe KESCO.

---

<sup>1</sup> [https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/PRC\\_HICP\\_AIND\\_\\_custom\\_4860030/default/table?lang=en](https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/PRC_HICP_AIND__custom_4860030/default/table?lang=en)

## **4. Komentet nga Qeveria e Republikës së Kosovës**

### **4.1 Ndarja e subvencioneve**

#### *4.1.1 Komentet e Qeverisë së Republikës së Kosovës*

Nga raporti, vërehet se është marrë parasysh edhe ndarja e 24.6 milionë eurove për subvencionim të tarifave nga ana e Qeverisë, mirëpo nuk është e qartë nëse janë marrë parasysh edhe Vendimet 01/117 dhe 02/117 të Qeverisë për mbështetjen e sektorit të energjisë elektrike me ndarjen edhe të 20 milionë eurove tjera shtesë dhe masa në të cilën janë shpenzuar dhe parashihen të shpenzohen gjatë javëve në vijim.

#### *4.1.2 Përgjigjja e ZRRE-së*

ZRRE me datë 15 mars 2023 ka dërguar shkresë Ministrisë së Ekonomisë për të marrë sqarime lidhur me fondet e alokuara për qëllime të subvencionit për vitin kalendarik 2023. Me datë 16 mars 2023, ZRRE ka pranuar sqarimet nga ME ku theksohet mjetet nga ndarja prej 24.6mil€ sipas vendimit 13/118 janë disbursuar për të përmbushur obligimet e muajit dhjetor 2022 dhe janar 2023.

Në këtë kuptim ZRRE ka përshtatur subvencionin e parashikuar për vitin 2023 nga vlera 24.6mil€ në 19.55 mil€ (vlera 19.55mil€ përfshinë subvencionin e disbursuar për muajin janar 2023 në vlerë prej 12.8mil€ pa TVSH dhe mjetet e mbetura prej 6.7mil€ nga fondi prej 90mil€). Vlera 6.7mil€ është kalkuluar si diferencë e  $90,000,000\text{€} - 83,254,572\text{€} = 6,745,428\text{€}$ .

### **4.2 Mbulimi i hendekut për HLM për 2023 të bëhet kryesisht nga bizneset**

#### *4.2.1 Komentet e Qeverisë së Republikës së Kosovës*

Për vitin 2023, sugjerojmë që tarifat për amvisëritë do të mbeten të pandryshuara, ndërsa mbulimi i hendekut të bëhet (në masë të madhe) duke përshtatur tarifat për bizneset, dhe sidomos bizneset e mëdha. Një përshtatje e tillë për bizneset e mëdha mund të shihet edhe në kontekstin e hapjes së tregut, ku tarifat e rregulluara do duhej që gradualisht të konvergjonin me tarifat që aktualisht janë në treg të hapur. Në shqyrtimin e ndodhur vitin e kaluar, përkundër propozimeve nga MFPT por edhe nga palë tjera siç është Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (SKE), ZRRE la të pandryshuara tarifat për bizneset, duke ndryshuar vetëm tarifat për amvisëritë me shtimin e bllokut të ri tarifor për konsumin mbi 800 kWh.

#### *4.2.2 Përgjigjja e ZRRE-së*

Subvencioni i zotuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në vitin 2022 ishte i dedikuar për të gjithë konsumatorët e energjisë elektrike. Prandaj, ZRRE e ka shpërndarë atë tek të gjithë konsumatorët, duke mbajtur kështu tarifa të njëjta për konsumatorët industrial, komercial dhe konsumatorët shtëpiak që kanë konsum nën 800kWh, ndërsa për konsumatorët shtëpiak me konsum mbi 800kWh ka përshtatur tarifat si vijon: tarifa e lartë nga 21.00€/kWh është përcaktuar në 12.52€/kWh, ndërsa tarifa e ultë nga 9€/kWh është përcaktuar të jetë 5.90€/kWh.

Lidhur me komentet e dhëna për rritje administrative të tarifave, ZRRE përsëritë se thellimi i ndër-subvencionimit përmes përcaktimit administrativ të çmimit nuk është rruga e duhur për arritjen e qëllimit të liberalizimit të tregut. ZRRE konsideron që një barrierë shtesë e liberalizimit të tregut është



bartja e kostos së ndër-subvencionimit tek konsumatorët që do të vazhdojnë të mbesim të rregulluar. Prandaj, kjo mund të arrihet vetëm duke aplikuar tarifa që reflektojnë koston për të gjitha kategoritë e konsumatorëve.

ZRRE gjatë përcaktimit të tarifave të kategorive të konsumatorëve bazohet në metodologjinë tarifore, ku janë të definuara parimet bazë duke marrë parasysh kostot e alokuara ndaj çdo kategorie të konsumatorëve që varen nga kostoja që secila kategori e konsumatorëve e shkakton në sistem. Në këtë kuptim ZRRE do të përcaktojë tarifat e për të gjitha kategoritë e konsumatorëve të rregulluar.

### **4.3 Lakorja e çmimeve të importit**

#### *4.3.1 Komentet e Qeverisë së Republikës së Kosovës*

Në faqen 9 të raportit ku tregohet për çmimin e importit për MWh dhe si referencë është EEX – PXE Hungarian Power Futures, duhet të sqarohet edhe lakorja e çmimeve se si ka ardhur deri tek vlera e përvetësuar prej 171.5 Euro/MWh (tabela 3).

#### *4.3.2 Përgjigjja e ZRRE-së*

Çmimi i parashikuar për blerjen e energjisë nga importi është bazuar në të dhënat e publikuara nga European Energy Exchange (EEX-PXE Hungarian Power Futures) për çmimet mujore që kanë rezultuar më 9 shkurt 2023.<sup>2</sup> Në kohën e publikimit të këtyre të dhënave, çmimet kanë qenë të parashikuara deri për muajin gusht, andaj për muajt e mbetur ZRRE ka bërë parashikimin duke bërë shpërndarje simetrike për muajt e mbetur. Kjo bursë është marr si burse referente, ngase është një nga bursat me likuide në rajon dhe për shkak të afërsisë gjeografike është marrë në konsideratë ashtu që të optimizohen kostot e alokimit të kapaciteteve.

Sidoqoftë, ZRRE në vazhdimësi ka përcjellur çmimet që kanë rezultuar në këto bursa, dhe duke qenë se në vitet fundit ato janë ndikuar për shkak të rritjes së kërkesës së përgjithshme për energji ndërsa ekonomitë globale rimëkëmben nga pandemia COVID-19 dhe reduktimin e ofertës së gazit si pasojë e luftës në Ukrainë, si çmimet e tilla janë dinamike. Si rrjedhojë nuk mund të rekomandohet një datë fiktive për parashikime të tilla, por ZRRE sygjeron sa datat më të fundit për parashikimin e çmimeve për të ardhëm janë më reprezentative, prandaj në propozimin përfundimtar ka përditësuar çmimet me shumicë duke u bazuar në të dhënat e datës 15 mars 2023.

### **4.4 Kostot për Fondin e BRE**

#### *4.4.1 Komentet e Qeverisë së Republikës së Kosovës*

Në tabelën 5, Kostot e Bartshme – Kostot për Fondin e BRE, kërkesa e FSHU-së për vitin 2023 është 3.77 milionë euro ndërsa propozimi i ZRRE-së është 12.37 milionë euro. Duhet të sqarohet qartë se si është arritur deri tek ky propozim.

#### *4.4.2 Përgjigjja e ZRRE-së*

Siç dihet kapacitet gjeneruese nga BRE-të nga viti 2022 janë rritur për shkak të hyrjes në operim të gjeneratorëve të rinjë. Prandaj, si rezultat i rritjet se kapaciteteve gjeneruese, përshtatjes së çmimit

---

<sup>2</sup> <https://www.eex.com/en/market-data/power/futures#%7B%22snippetpicker%22%3A%2223%22%7D>

të BRE-ve për inflacion janë rritur kostot e fondit. Në këtë kuptim këto kosto duhet të reflektohen në tarifën të fondit për burimet e ripërtëritshme për vitin 2023. FSHU në mungesë të të dhënave në dispozicion ka aplikuar tarifën aktuale, ngase kostot e Fondit të Burimeve të Ripërtëritshme menaxhohen nga operatori i tregut në përputhje me rregullën për skemën mbështetëse dhe parashikimi i kostove të BRE-ve bëhet nga OST/OT.

Megjithatë ZRRE, ngjashëm sikurse në kostot me shumicë ka përditësuar kostot e fondit të BRE-ve për të reflektuar të dhënat e realizuara për muajt janar dhe shkurt, dhe konsumin e azhurnuar. Në këtë kuptim kostot e fondit janë korigjuar nga vlera 12.4mil€ sa ishte propozimi fillestar në vlerën 11.8mil€ në propozimin përfundimtar. Gjithsesi, duke pasur parasysh se mund të ketë dallime ndemjet vlerave të parashikuara dhe atyre të realizuara, ZRRE në fund të çdo viti bënë përshtatjet vjetore.

## **5. Komentet nga Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës**

### **5.1 Shqyrtimi i subvencioneve dhe shmangja e rritjes së tarifave**

#### *5.1.1 Komentet e ZPRK-së*

ZPRK-ja rekomandon që në këtë shqyrtim të jashtëzakonshëm tarifor të vlerësohen mundësitë për shmangie të rritjes së tarifave duke inkurajuar komunikimin dhe koordinimin ndërinstytucional me qëllim të sigurimit të subvencionimit të kostove shtesë të cilat kanë ndikuar në rritjen e vështirësive për operatorët e rregulluar.

Në veçanti, potencojmë rëndësinë e shmangies së një vendimi të tillë nga ZRRE-ja, duke qenë se bazuar në praktikën nga e kaluara, pas vendimeve të marra në procese për shqyrtim të jashtëzakonshëm të tarifave nuk është bërë asnjëherë një rivlerësim pasues, i cili eventualisht do të ndikonte në rikthimin e tarifave origjinale të vlefshme para rritjes në rast të rehabilitimit të faktorëve të cilët fillimisht kanë shkaktuar nevojën për shqyrtim të jashtëzakonshëm

#### *5.1.2 Përgjigjja e ZRRE-së*

Ligji për Rregullatorin e Energjisë përcakton që tarifën e shërbimit të energjisë elektrike të vendosen në nivel që mbulon kostot e arsyeshme të shërbimit. Kostot e blerjes së energjisë me shumicë, sidomos kostot e importit – që janë ndikuesi kryesor i ndryshimit të çmimeve – janë në masë të madhe jashtë kontrollit të operatorëve të rregulluar. ZRRE është e mandatuara ligjërisht që të vlerësojë ndikimin e këtyre kostove në të hyrat e lejuara maksimale dhe të përcaktojë tarifa që sigurojnë mbulimin e këtyre kostove për të mirëmbajtur sigurinë e furnizimit në sistem.

Sa i përket komunikimit dhe koordinimit ndërinstytucional, ZRRE beson fuqimisht se konsultimi publik është në qendër të politikave rregullatore efektive. Për këtë qëllim, ZRRE-ja u ofron kompanive të rregulluara, konsumatorëve dhe të gjitha palëve të interesuara mundësinë që të shqyrtojnë dëshmitë dhe pikëpamjet e paraqitura në këtë raporte konsultative, me të cilat ata mund të mos pajtohen, dhe të komentojnë ato, duke paraqitur kundër argumente ose duke ofruar të dhëna të reja të cilat ZRRE-ja mund të mos i ketë marrë parasysh.

Lidhur me komentin e ZPRK-së, se nuk është bërë asnjëherë një rivlerësim pasues tarifave pas shqyrtimit të jashtëzakonshëm, ZRRE sqaron se tarifën në vitin 2016 janë zbritur për 8% për konsumatorët industrial dhe komercial, në vitin 2017 janë zbritur për 3.5% në mënyrë lineare për të

gjithë konsumatorët e rregulluar për të reflektuar përjashtimin e kostove të furnizimit në katër komunat e veriut dhe në vitin 2018 tarifat janë zbritur për 5% për konsumatorët industrial dhe komercial.

Këto veprime rregullatore kanë bërë që gradualisht të reflektohen kostot e shërbimit me energji elektrike për secilin grup të konsumatorëve.

Ngjashëm me praktikën e kaluara dhe konform legjislacionit, ZRRE do të përcaktojë tarifën e rregulluar për reflektuar kostot e shërbimit me energji elektrike për secilin grup të konsumatorëve të rregulluar.

## **6. Komentet nga FSHU - KESCO**

### **6.1 Kostot e blerjes së energjisë me shumicë për vitin 2023**

#### *6.1.1 Komentet e KESCO*

Megjithëse, ZRRE në vlerësimin e blerjeve për vitin 2023 është bazuar në konsumin e parashikuar sipas Bilancit të energjisë të aprovuar me ndryshime për vitin 2023, parashikimi i blerjeve nuk është aplikuar njëtrajtësisht me parashikimin e konsumit në baza mujore. Marrë parasysh si më lartë, FSHU në këtë aplikim ka përdorur të dhënat e konsumit Bilancit të energjisë të aprovuar me ndryshime për vitin 2023, por ka përditësuar kostot e blerjeve sipas parashikimit mujor të konsumit.

Marrë parasysh kërkesën e ZRRE-së për përditësimin e çmimeve me inflacion për BRE-të në marrëdhënie kontraktuale, FSHU në aplikimin e tij ka reflektuar ndryshimet, megjithatë gjatë raportit konsultativ është vërejtur se ZRRE nuk ka aplikuar ndryshimet. Si rezultat, FSHU në këtë aplikim ka përdorur sërish çmimin e përshtatur me inflacion për BRE-të në marrëdhënie kontraktuale me FSHU-në.

Gjithashtu FSHU në këtë aplikim ka përditësuar çmimin e importit në bazë të parashikimeve të fundit në bursat ndërkombëtare.

Në aplikimin e tij FSHU ka paraqitur edhe kostot për kapacitet për energjinë nga KESH, të cilat kosto janë të domosdoshme për shfrytëzimin e plotë të kësaj energjie, në të kundërtën mos-njohja e kostove të kapacitet rrezikon sjellën e energjisë nga KESH, duke rrezikuar që kjo energji tutje të mbulohet përmes importit ditor (intraday) e cila ka kosto më të lartë dhe të panjohur në tarifa në vitin relevant.

#### *6.1.2 Përgjigja e ZRRE-së*

ZRRE ka rishikuar kostot me shumicë bazuar në të dhënat aktuale për muajt janar dhe shkurt të vitit 2023, si dhe ka azhurnuar parashikimet e çmimeve të importit sipas të dhënave të datës 15 mars 2023 sipas EEX. ZRRE ka pranuar edhe kostot e alokimit të kapaciteteve për energjinë e shfrytëzuar nga FSHU në muajt janar –shkurt 2023, si dhe ka përshtatur kostot e subvencioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2023 bazuar në sqarimet e dhëna nga ME të përshkruara më lartë.

Meqë gjatë procesit tarifor FSHU ka kërkuar përditësimin e çmimeve për HC me koncesion duke aplikuar një qasje ndryshe nga ajo e paraparë marrëveshje kontraktuale, ZRRE në këtë proces tarifor ka marrë parasysh çmimet aktuale deri në definimin e përshtatjes së kostove për periudhën paraprake dhe përcaktimin e çmimeve për këto HC distributive në të ardhmen.

## 6.2 Kostot e lejuara me pakicë

### 6.2.1 Komentet e KESCO

ZRRE me vendim nr. V\_1476\_2022 ka aprovuar vlerat hyrëse dhe shpenzimet operative (OPEX) për periudhën 2022-2024. Sipas këtij vendimi OPEX i aprovuar për vitin 2023 është 5.1 milion €.

Duke marrë parasysh kërkesat për rritje të pagave nga punonjësit, dhe nevojat e analizuara në detaje, OPEX-i i propozuar nga FSHU-ja është në vlerë prej 5.71 milion €. FSHU në këtë raport ka aplikuar normën e inflacionit prej 8.39% sipas normës së inflacionit që përdor ZRRE-ja duke u bazuar në të dhënat e Eurostat në përshtatjet e kostove zhvlerësimit dhe OPEX-it të aprovuar për vitin 2022.

### 6.2.2 Përgjigjja e ZRRE-së

Sipas rregullës për të hyrat e lejuara maksimale, ZRRE ka rishikuar kostot e OPEX (ku përfshihen edhe kostot e personelit) duke reflektuar normën vjetore të inflacionit. Norma e inflacionit merr parasysh Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit të publikuar nga Eurostat. Vlera e publikuar në janar të vitit 2023 për vitin 2022 është 8.4%.<sup>3</sup>

## 6.3 Përshtatjet dhe Faktori Korrigjues i të Hyrave

### 6.3.1 Komentet e KESCO

ZRRE në raportin konsultativ ka vlerësuar përshtatjet për vitin 2022 në vlerë prej 39.5 milion. Në përshtatjet për vitin 2022, ZRRE nuk ka marr parasysh përshtatjet e përditësuar për vitin 2021 të cilat kanë përfshirë të gjitha kostot finale të shkaktuara gjatë vitit 2021 e të cilat nuk janë reflektuar në HLM të aprovuar për vitin 2022, marrë parasysh se ishte proces i jashtëzakonshëm dhe të dhënat e muajit dhjetor 2021 ishin preliminare. Në përshtatjet e përditësuara për vitin 2021, FSHU gjithashtu ka përfshirë edhe kostot për jo balanca të cilat ZRRE nuk i ka njohur si kosto të realizuara për vitin 2021 gjatë procesit për përcaktimin e HLM për vitin 2022.

### 6.3.2 Përgjigjja e ZRRE-së

Ashtu siç është sqaruar edhe në vitin 2022, FSHU në mënyrë sistematike dhe të qëllimshme në vitin 2021 kishte devijuar nga kërkesa reale për konsum me energji elektrike, prandaj ZRRE nuk njohur kostot e tilla. Ndërsa, lidhur me faktorin korrigjues të të hyrave KREV për vitin 2021, ZRRE kishte sqaruar se ai është përditësuar për të reflektuar të dhënat e fundit.

---

<sup>3</sup> [https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/PRC\\_HICP\\_AIND\\_\\_custom\\_4860030/default/table?lang=en](https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/PRC_HICP_AIND__custom_4860030/default/table?lang=en)

## 7. Përmbledhje e MAR të FSHU (KESCO)

Pas vlerësimit të të gjitha të dhënave në dispozicion dhe atyre të paraqitura nga palët e përfshira në proces, si dhe pas komenteve të pranuar nga palët gjatë konsultimit publik, duke marrë në konsideratë edhe kostot e bartshme të OST/OT-së dhe OSSh-së, vlerësimi dhe propozimi përfundimtar i ZRRE-së për të Hyrat e Lejuara Maksimale për FSHU (KESCO) për vitin kalendarik 2023 është si më poshtë:

HLM i Furnizuesit me Shërbim Universal	Njësia	Propozimi i rishikuar FSHU 2023	Propozimi përfundimtar ZRRE 2023
<b>Parametrat e indeksimit</b>			
Norma e interesit It	%	6.85%	6.91%
<b>Kostot me pakice te furnizuesit</b>			
$OPEX - OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$	€m	5.71	5.62
Zhvlerësimi - $DEPC_t = DEPC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$	€m	0.12	0.12
<b>Kostot e bartshme</b>			
Kostot e OST	€m	22.25	23.15
Kostot e OSSh	€m	151.97	149.34
Kostot për fondin e BRE	€m	12.37	11.77
<b>Kapitali punues (WCLCt)</b>			
$WCLC = (1 / 12) * It * (RETR_t + WHPC_t + PSTC_t - NTFR_t)$	€m	1.99	2.00
<b>Kostot për blerjen e energjisë</b>			
Kostot e blerjes së energjisë me shumicë	€m	152.74	158.15
<b>Taksa për licencë</b>			
Taksa për licencë	€m	0.04	0.04
<b>Borxhi i keq (BDTA)</b>			
BDTA	%	2.2%	2.2%
BDTA	€m	8.80	8.77
<b>Përshtatjet e të hyrave për FSHU</b>			
Përshtatjet e vitit 2022	€m	44.10	39.49
<b>Të hyrat e lejuara maksimale</b>	<b>€m</b>	<b>400.09</b>	<b>398.44</b>